



ПЛАТФОРМА
ЗА РОДОВА
ЕДНАКВОСТ

DEKLARATË

PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR NËDËRPRERJEN E SHTATZËNISË
DHE SIGURIMIN E MBROJTJES SË SHËNDETIT DHE TË DREJTAVE RIPRODHUESE TË FEMRËS

Duke u thirrur në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë me të cilën e drejta e femrës të vendos për krijimin e fëmijëve (neni 41), dhe të drejtën dhe detyrën e femrës që ta mbrojë dhe ta avancojë shëndetin e saj (neni 39), janë të drejta të garantuara me kushtetutë..

Duke pasur parasysh obligimin e shtetit për mënjanimin e pengesave për vendosjen e barazisë mes femrave dhe meshkujve, përmes parandalimit dhe heqjes së trajtimit jo të barabartë në pajtim me Ligjin për mundësi të barabartë të femrave dhe meshkujve (neni 2).

Duke u përkujtuar në obligimet nga Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit mbi femrën, me të cilën mbrohet e drejta për shëndet dhe me të cilën i obligon shtetet anëtare ta eliminojnë diskriminimin mbi femrën në fushën e mbrojtjes shëndetësore (neni 12).

Të nxitur nga rekomandimi prej 20 korrik 2015 të Komitetit për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, se Republika e Maqedonisë duhet ta ndryshojë Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë që të eliminohen të gjitha pengesat procedurale,

me të cilat e sjellin femrën që të miratojë aborte jo legale, me çka e kërcënon shëndetin dhe jetën.

Por, para së gjithash, jemi të brengosur për rastet e shpeshta të pacienteve, me të cilat janë ballafaquar me rreziqe shëndetësore nga aplikimi i ashpër i dispozitave të Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë nga viti 2013.

Deputetët e partisë sonë në përbërjen e re parlamentare, pas zgjedhjeve parlamentare të 11 dhjetorit 2016, obligohen:

- të bëjnë ndryshime të Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë dhe atë në dispozitat të cilat e kufizojnë qasjen deri te aborti i femrës në institucionet shëndetësore dhe e kërcënojnë të drejtën e mbrojtjes shëndetësore dhe të drejtave riprodhuese;

- në mënyrë transparente dhe participative të gjithë palët e interesuara, duke përfshirë edhe organizatat qytetare, në proceset e sjelljes së rregullativave të reja ligjore, gjatë së cilës ndiqen rekomandimet e Organizatës Shëndetësore Botërore dhe obligimet nga dokumentet nacionale dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

VMRO-Partia Popullore

Përtëritja Demokratike e Maqedonisë (PDM)

Dinjiteti

E mjata

Partia Liberale PL

Partia Liberato-Demokratike

Partia e Re Social Demokratike (PRSD)

Të Bashkuar për Maqedoninë

Partia për Emancipim të Plotë të Romëve (PEPR)

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM)